



Partia për Veprim Demokratik
The Party for Democratic Action
17523 Preshevë, R. Sadiku 3
tel/fax: + 318(0)17 660 086
e-mail: riza_halimi@yahoo.com
27.02.2014
P r e s h e v ë

K U M T E S Ë

Kryesia e Partisë për Veprim Demokratik në mbledhjen e sotshme ka vendosur që në zgjedhjet parlamentare të 16 marsit të paraqitet me listën e dhjetë kandidatëve për deputet.

Duke analizuar rrjedhat e përgjithshme politike, por edhe me qëllim të mobilizimit maksimal të elektoratit në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Partia për Veprim Demokratik, ka vendosur që për dy vendet e para të kandidoj dy udhëheqësit kryesorë të saj, Riza Halimin-Kryetar dhe Shaip Kamberin-Nënkryetar.

Me këtë rast kryesia e vlerësoi që për hirë të kontinuitetit, pjesën e mandatit deri në fund të këtij viti ta ushtrojë Riza Halimi, ndërsa pjesën tjetër Shaip Kamberi.

Partia për Veprim Demokratik, listën e vet për deputet do ta dorëzoj në komisionin zgjedhor të premtën e 28 shkurtit.

Njëkohësisht, kryesia e PVD-së falënderon të gjithë përkrahësit e vet dhe qytetarët tjerë për mbështetjen që I dhanë listës zgjedhore të PVD-së, që nga shpallja e zgjedhjeve parlamentare.

Kryetari i PVD – së

Riza HALIMI